



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

VENDIM

Nr. 43 Datë 29.09.2021

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË II-të PERIODIK TË MONITORIMIT TË BUXHETIT TË BASHKISË KUKËS PËR PERIUDHËN JANAR – GUSHT 2021

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.3/c, 54, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, nenet 7 dhe 48, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), udhëzimin e Ministrise se Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, (i ndryshuar), udhëzimit nr.22 date 30.07.2018 “Për proçedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit të Kryetarit Bashkisë Nr. 166, datë 26.03.2021 “Për përgatitjen e Buxhetit vendor të Bashkisë Kukës, vendimin e Këshillit të Bashkisë Kukës Nr.167, datë 23.12.2020 “Për miratimin e Kalendarit të PBA-së 2022-2024”,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin e II-të periodik të zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën Janar – Gusht 2021, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Kukës.

